


Tregtia e jashtme e mallrave

Qershor 2024

Tiranë, më 17 Korrik 2024: Në Qershor 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë, duke u ulur me -8,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -0,1 %, në krahasim me Maj 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 77 mld lekë, duke u rritur me 2,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me -3,3 %, në krahasim me Maj 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u rritur me 13,4 %, krahasuar me Qershor 2023 dhe duke u ulur me -5,9 %, në krahasim me Maj 2024.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë gjashtëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 199 mld lekë, duke u ulur me -14,9 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 440 mld lekë, duke u rritur me 0,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 241 mld lekë, duke u rritur me 17,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Qershor 2024, në uljen e eksporteve prej -8,9 %, kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me -6,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje, etj. Pozitivisht ka ndikuar grupi: “Të tjera” me +4,2 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2024




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë ulur me -14,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -5,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -5,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,2 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Qershor 2024, në rritjen e importeve prej +2,1 %, krahasuar me Qershor 2023, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +1,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,7 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,7 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,2 pikë përqindje, etj.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2024



Si gjashtëmujor, importet janë rritur me +0,3 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,4 pikë përqindje, etj.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Qershor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2023 janë: Italia (11,2 %), Greqia (15.0 %), Spanja (40.0 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (3,9 %), Gjermania (9,5 %), etj.

Gjatë këtij gjashtëmujori vendi me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, është: Italia (14,9 %), Kosova (1,5 %) ,Greqia (24,8 %), etj. Ndërsa vendi me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kina (25,0%), etj.

Në muajin Qershor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Greqia (9,2 %), Kosova (132,9 %), Maqedonia e Veriut (7,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (1,2 %), Kina (1,9 %), Turqia (5,3 %), etj.

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (16,7 %), Greqia (16,8 %), Gjermania (3,6 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (4,4 %), Kina (9,3 %), Maqedonia e Veriut (11,8 %), etj.

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 56,6 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,3 %), Kina (8,9 %), Turqia (7,0 %) dhe Greqia (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 58,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Qershor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,7 %), Turqia (8,5 %), Kina (7,5 %) dhe Greqia (7,3 %)

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vietet (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vietet (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	Janar – Qershor 21	177	40,9	354	30,5	-178	49,9
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	Janar – Qershor 22	253	43,3	446	25,9	-193	56,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	Janar – Qershor 23	234	-7,4	439	-1,6	-204	53,4
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	Janar – Qershor 24	199	-14,9	440	0,3	-241	45,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë). Qershor 2024

	Eksporte				Importe			
	Qershor 2023	Qershor 2024	Jan. - Qershor 2023	Jan. - Qershor 2024	Qershor 2023	Qershor 2024	Jan. - Qershor 2023	Jan. - Qershor 2024
Vendet e BE-së	28.819	23.814	173.571	142.361	38.211	39.265	225.480	229.176
Austri	315	279	2.187	1.403	567	621	3.637	3.720
Gjermani	1.689	1.849	12.887	11.114	5.155	4.995	30.221	31.302
Greqi	2.463	2.093	16.172	12.159	5.186	5.665	29.330	34.258
Itali	16.520	14.677	103.390	88.018	17.009	16.809	100.150	95.768
Spanjë	1.738	1.043	9.516	6.583	913	1.354	6.403	6.892
Kroaci	475	326	3.106	2.460	841	615	3.459	1.957
Të tjera të BE-së	5.619	3.549	26.314	20.625	8.541	9.206	52.280	55.279
Mbretëri e Bashkuar	171	134	852	783	672	704	4.221	4.829
Kinë	1.027	961	4.295	5.371	9.173	8.994	46.784	42.429
Kosovë	3.434	3.568	20.375	20.063	865	2.014	5.411	6.845
Maqedonia e Veriut	871	1.015	10.100	7.387	967	1.042	6.778	5.978
Rusi	0	-	8	5	211	280	2.581	1.642
SHBA	304	298	2.235	2.114	1.564	1.428	8.880	10.235
Turqi	285	312	2.221	2.131	7.909	7.494	44.914	52.426
Ukrainë	51	1.693	995	2.403	309	192	1.981	2.050
Zvicër	403	356	3.014	1.299	738	723	7.644	3.657
Të tjera	2.745	2.581	16.618	15.352	14.477	14.541	84.040	80.968
Gjithsej	38.110	34.732	234.286	199.269	75.096	76.677	438.714	440.234

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë). Qershor 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 2023	Qershor 2024	Jan. - Qershor 2023	Jan. - Qershor 2024	Qershor 2023	Qershor 2024	Jan. - Qershor 2023	Jan. - Qershor 2024
Gjithsej	38.110	34.732	234.286	199.269	75.096	76.677	438.714	440.234
Ushqime, pije, duhan	7.172	4.880	30.607	27.561	12.750	13.956	69.266	74.826
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	6.638	6.446	50.929	38.823	7.105	7.628	49.647	42.003
Produkte kimike dhe plastike	1.275	1.217	7.829	7.654	10.051	9.937	59.889	58.130
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	206	175	1.566	1.156	1.168	1.052	7.703	6.343
Prodhime druri dhe letre	911	826	5.969	5.022	2.837	2.666	15.331	14.741
Tekstile dhe këpucë	10.999	9.264	68.102	55.416	8.071	7.426	48.414	42.694
Materiale ndërtimi dhe metale	6.327	6.024	41.946	36.843	10.233	11.297	64.210	63.331
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.535	3.266	20.926	19.211	19.795	19.281	106.456	118.587
Të tjera	1.047	2.633	6.411	7.583	3.088	3.433	17.798	19.578

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Qershor 2024

	Itali		Kosovë		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	103.390	88.018	20.375	20.063	16.172	12.159	12.887	11.114
Ushqim. pije duhan	7.880	7.309	3.307	3.149	2.346	2.103	945	854
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	5.604	7.388	4.093	4.475	5.793	1.637	4.953	3.440
Produkte kimike dhe plastike	3.093	2.931	2.060	1.988	577	488	25	22
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.485	979	7	3	14	126	3	1
Prodhime druri dhe letre	3.572	2.703	561	571	939	807	70	65
Tekstile dhe këpucë	53.212	41.937	122	84	3.602	4.146	5.070	4.761
Materiale ndërtimi dhe metale	14.410	11.689	8.216	7.988	2.273	2.301	764	353
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	11.274	10.298	1.119	1.132	65	121	877	1.383
Të tjera	2.860	2.783	892	672	566	431	180	234

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Qershor 2024

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	100.150	95.768	44.914	52.426	46.784	42.429	29.330	34.258
Ushqim. pije duhan	13.342	15.152	3.179	2.827	966	880	8.588	9.526
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	3.345	2.198	6.107	6.952	24	7	3.189	5.071
Produkte kimike dhe plastike	12.567	11.645	6.312	6.063	3.910	3.545	5.039	5.870
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.308	4.981	169	177	377	452	14	110
Prodhime druri dhe letre	3.402	3.050	2.607	2.368	924	836	1.985	2.025
Tekstile dhe këpucë	23.204	18.758	7.517	5.679	5.961	6.512	2.695	3.338
Materiale ndërtimi dhe metale	13.724	11.859	10.562	15.068	6.429	5.976	4.768	4.909
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	19.993	22.813	6.307	11.053	24.831	20.455	2.013	2.149
Të tjera	4.265	5.312	2.154	2.240	3.361	3.765	1.038	1.259

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri